

VENDIM
Nr. 863, datë 24.12.2019

**PËR NJË RISHPËRNDARJE FONDESH NË BUXHETIN E VITIT 2019,
NDËRMJET MINISTRISË SË FINANCave DHE EKONOMISË DHE
MINISTRISË SË SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 44, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të ligjit nr. 99/2018, “Për buxhetin e vitit 2019”, të ndryshuar, dhe të shkronjës “b”, të nenit 8, të ligjit nr. 57/2019, “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në buxhetin e miratuar për vitin 2019, të bëhet rishpërndarja e fondeve ndërmjet Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë dhe Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, si më poshtë vijon:

a) Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë t’i pakësohet fondi prej 300 000 000 (treqind milionë) lekësh në programin buxhetor “Sigurimi shoqëror”, të buxhetit të shtetit, për shpenzime korrente, në artikullin 604, “Transferte nga buxheti i shtetit në buxhetin e Institutit të Sigurimeve Shoqërore”;

b) Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale t’i shtohet fondi prej 300 000 000 (treqind milionë) lekësh në programin buxhetor “Përkujdesi social”, për shpenzime korrente, në artikullin 606, “Transferte për buxhetet familjare dhe individët”.

2. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama